



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*Komision për dhënie mendimi*)
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*Komision përgjegjës*)
3. Shqyrtimi i vendimit për propozimin Kuvendit "Për lirimin e një anëtari caktuar kryetar të Këshillit Drehtues të AKEP-it" (*Komision përgjegjës*)
4. Shqyrtimi i vendimit për propozimin Kuvendit "Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drehtues të AKEP-it" (*Komision përgjegjës*)
5. Seancë dëgjimore me kandidaturën për anëtar të Këshillit Drehtues të AKEP-it" (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Robert Bitri, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni, Fadil Nasufi dhe Edlira Hyseni.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Lefter Koka dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë
Irena Malolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Gent Sala – Kryetar i AMA-s
Bleron Dokle – Drejtor i Drejtorise Juridike dhe Integritimit në AKEP
Jetmir Braha – Drejtor i Drejtorise se Autorizimeve në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Relator për këtë projektligj është zoti Pëllumbi. Ky projektligj është parashikuar të kalojë në seancën plenare të datës 18 dhjetor. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Ne sot do të bëjmë prezantimin dhe shqyrtimin e këtij projektligji dhe, në varësi të ecurisë, do të shikojmë nëse do të arrijmë në miratimin e tij apo do ta lemë për një seancë tjetër. Prezent kemi zotin Gent Sala, kryetar i AMA-s. Nga AKEP-i kemi prezent zotin Jetmir Braha dhe zotin Bleron Dokle.

Zoti Pëllumbi, a dëshironi të bëni një prezantim të shkurtër?

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Atëherë, ligji “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë vjen si rezultat i nevojës që lind pikërisht për zgjerimin e bazës së veprimtarisë së tij, duke përfshirë brenda edhe zhvillimet e vrullshme, që kanë ndodhur në teknologjinë e informacionit, por kryesisht ka të bëjë me shërbimet elektronike. Që në fillim dua të theksoj se për këtë projektligj ka pasur një konsultim të gjerë dhe shumë debate për vetë rëndësinë që ai ka. Gjithsesi, janë bërë 4 tryeza të konsultimit publik, që i përkasin periudhës: fundi i vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019. Gjithashtu, dua të sqaroj edhe kolegët për mënyrën dhe procedurën se si ky projektligj vjen dhe diskutohet në komisionet tona si një propozim i Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ky projektligj ka marrë parasysh shumë vërejtje dhe propozime që janë bërë si nga kolegët tanë, ashtu edhe nga OSBE-ja, duke rezultuar në hartimin e një varianti integral të përmirësuar, të cilit, gjithashtu, unë propozoj që t'i referohemi gjatë shqyrtimit që do të bëjmë në këtë komision. Theksoj se ne jemi komision për dhënie mendimi, ndërkohë që Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Medies do ta shqyrtojnë këtë projektligj në detaje. Pra, për aq sa na takon, ne do ta diskutojmë dhe më pas, duke marrë edhe mendimet e kolegëve, do të biem dakord nëse do ta kalojmë edhe votimin e tij nen për nen.

Gjithsesi, ky projektligj krijon një kornizë ligjore dhe disiplinon disa tregues. Në radhë të parë projektligji garanton të drejtën e informimit dhe lirisë së shprehjes, që është një e drejtë shumë e rëndësishme e fituar tashmë prej gati 30 vjetësh, por krahas saj, projektligji duhet të garantojë dhe besoj se e garanton edhe ruajtjen e privatësisë së qytetarëve. Një arritje tjetër e rëndësishme e këtij projektligji, sipas këndvështrimin tim, është edhe moslejimi i

transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve; në mënyrë të veçantë projektligji kufizon dhe ndalon nxitjen e dhunës. Duhet të kemi parasysh se zhvillimet e fundit teknologjike krijojnë një ndryshim të madh midis transmetimeve audio dhe audiovizive, për të cilat fillimisht është hartuar ligji për mediet në vitin 2013, duke pasur sot një përhapje shumë të madhe. Këtu e kam fjalën për portalet *online*, pra krijon një shtrirje, një lehtësi dhe akses të pakufizuar të shumë njerëzve në informacionet që ata transmetojnë. Pikërisht për këtë arsye lind edhe nevoja për të bërë një ndërhyrje legjislativë për të kuadruar ligjin edhe për këto shërbime të reja që u janë ofruar qytetarit, duke synuar parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative që mund të sjellin keqinformimet apo lajmet e rreme. Nga ana tjetër, janë pikërisht këta faktorë që ulin në një mënyrë të papranueshme edhe besueshmërinë dhe pavarësinë e gazetarisë profesionale, çka ka të bëjë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me vlerat demokratike të shoqërisë sonë, njëkohësisht edhe me të drejtat e njeriut.

Në përfundim të fjalës sime dua të theksoj në mënyrë të përmblodhur se cilat janë në esencë disa nga qëllimet dhe arritjet e këtij projektligji, që kanë të bëjnë me normimin e veprimtarisë së shërbimeve publike elektronike; garantimin e të drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes; mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; respektimin dhe garantimin e të drejtës të ruajtjes së jetës private; moslejimin e publikimeve që nxisin dhunë, gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme e të tjerë; si dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Gjithashtu, dua të theksoj se ky projektligj është bazuar në modelin e ligjit kroat, i cili është një ligj i përafëruar me legjislacionin e BE-së, duke pasur parasysh që edhe ligji 97/2013 i ndryshuar është, gjithashtu, i përafëruar plotësisht me direktivën 2010 të BE-së. Pra, në vetvete edhe ky projektligj synon përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së.

Projektligji është publikuar edhe në regjistrin e konsultimeve publike, por, gjithsesi, është duke iu nënshtruar një diskutimi të gjerë. Kur të kalojmë në diskutimin nen për nen, dua të them edhe disa gjëra të tjera.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Gjuzi, a do t'ua japim fjalën përfaqësuesve, apo doni të thoni diçka për procedurë?

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, miq dhe ju administratorë të programeve tona të medias, shqetësimi im kryesor jo vetëm si deputet i Kuvendit, por edhe si kryetar i Partisë Konservatore është se qeveria “Rama” ka ndërmarrë një hap radikal në tërheqjen e medias

drejt një autoriteti të komanduar prej tij, sikurse është televizioni i tij, duke ushtruar presion tek të gjitha mediet e tjera. Në dy –tri raste unë personalisht kam pasur censurim të fjalëve të mia, pavarësisht se kam qenë në ambientet e shtetit shqiptar, siç janë Kryeministria, Kuvendi apo diku tjetër, por sot ju kërkoj juve, zoti kryetar, të mbani një qëndrim për ndalimin e dy personave, të cilët kanë faqen *online* “JOQ”, ose ndryshe “Jeta osh qejf”, ku unë jam përfolur. Unë në asnjë rast nuk u kam bërë atyre presion për t’i çuar në gjykatë. Theksoj: nëse ne do të kontrollojmë medien, kjo do të thotë se po shkojmë drejt diktaturës së kolonel Gedafit. Prandaj, unë ju bëj ftesë të gjithë deputetëve këtu, sidomos deputetëve të opozitës, të jemi më të vëmendshëm gjatë gjithë kohës së kalimit të këtij ligji.

Faleminderit, zoti kryetar!

Niko Peleshi - A e keni për procedurë?

Dakord!

Halit Valteri – Të nderuar kolegë, unë kam një pyetje për përfaqësuesit e AKEP-it, të cilën e preku pak edhe zoti Gjuzi. Unë e dëgjova me vëmendje zotin Pëllumbi dhe në relacionin që ai ka bërë thuhet se me anë të këtij projektligji garantohet liria e shprehjes. Atëherë, si ka mundësi që të gjitha kompanive që transmetojnë internet në të gjithë Shqipërinë u është dërguar një *email* nga AKEP-i, ku u thotë se duhej t’ia ndalonin frekuencën faqes “Jeta osh qejf”, ndërkohë që ajo është faqja me më shumë se 1 milion shikime, është një faqe që kohët e fundit ka bërë opozitë dhe ka qenë kundër qeverisë ose kundër veprimeve të qeverisë? Tani, ose po përdoret AKEP-i politikisht nga qeveria, ose na thoni që t’i mbyllim të gjitha këto faqe dhe të lemë vetëm ERTV-në të transmetojë. Unë e kam *email*-in, ndaj ju lutem, a mund të na specifikoni se nga kush ka ardhur ky urdhër dhe si e keni marrë këtë vendim për t’ua dërguar të gjitha kompanive që shpërndajnë internetin?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani dhe më pas zoti Pëllumbi.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

E kam për procedurë, zoti kryetar.

Ne e filluam prezantimin e këtij projektligji me relatorin dhe mendoj që të vazhdojmë me prezantimin e tij. Më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime, sepse këtu kemi dy projektligje që duhet t’i diskutojmë. Pra, ne kemi filluar me projektligjin e parë, ndaj mendoj që vazhdojmë me prezantimin dhe më pas do të bëjmë pyetje dhe komente.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pas, kur të kalojmë te ligji i AKEP-it, do të flasim edhe për këtë.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Dua të bëj një ndërhyrje të vogël, meqenëse m'u përmend emri.

Kuadri që ky ligj garanton në mënyrë të pa diskutuar është në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe lirisë së shprehjes. Për raste konkrete të shkëputura, të cilave ne, sigurisht, këtu në komision nuk u japim dot përgjigje në rolin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, mund të gjejmë përgjigje nga të ftuarit që janë këtu, por këto raste të shkëputura nuk duhet të na bëjnë të keqpërdorim apo të keqinterpretojmë një kuadër ligjor, i cili rregullon një fushë që për momentin është e parregulluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Tani, vërejtja qëndron dhe unë jua dhashë fjalën, pasi e kërkuat për procedurë, por, ju lutem, të mos futemi në çështje, të cilave nuk u ka ardhur ende radha për t'u diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e keni për procedurë, zoti Kujtim, se nuk mund të flasim pa dëgjuar një prezantim.

Kujtim Gjuzi - Së pari, ju të maxhorancës mos ushtroni tryzni dhe presion edhe këtu brenda komisionit. Nuk e kam fjalën për ju kryetar, por e kam fjalën në këtë moment për zotin Pëllumbi, se zonjën nuk dua që ta përflas në këtë rast, por ne kemi mendimin tonë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, ju lutem, i nderuar koleg!

Pra, ne kemi mendimin tonë, ndaj, ju lutem, mos na intimidoni kur ne flasim. Ne kemi kohë për diskutime, kemi kohë për debate, por ne nuk mund të lejojmë që Edi Rama të ketë televizionin e tij. Këtë gjë le ta harrojë Edi Rama dhe çdonjëri prej jush.

Niko Peleshi – Dakord! Kush dëshiron ta prezantojë projektligjin nga përfaqësuesit e AMA-s?

(Diskutime pa mikrofon)

Nga Ministria e Drejtësisë? Dakord!

Besmir Beja – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam Besmir Beja, drejtor i Përgjithshëm i Komunikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Duke qenë se kjo nismë është bashkëpropozim i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, besoj se mund ta bëj unë prezantimi në këtë rast.

Faleminderit që më dhatë mundësinë për të folur!

Duke pasur në konsideratë pozitën e gazetarëve dhe të medias në tërësi, ashtu si dhe rolin e tyre në kuadër të lirisë së shprehjes dhe dhënies së informacionit në interes të

publikut, në raport me influencën e portaleve *online*, gjatë viteve të fundit në vendin tonë Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ka ndërmarrë nismën ligjore me qëllim amendimin e ligjeve aktualisht në fuqi në fushën e komunikimeve elektronike dhe medieve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, ajo që gjerësisht njihet si “Paketa antishpifje”. Sjellim në vëmendje disa nga problematikat e konsideruara, të cilat kanë diskutuar nevojën për ushtrimin e iniciativës përkatëse legislative në drejtim të paketës antishpifje, të cilat konsistojnë si më poshtë:

Së pari, është mungesa e një rregullimi shterues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike. Mediet elektronike janë një trend në rritje, të cilat po shmangin dhe po zëvendësojnë mediet tradicionale, për shkak edhe të lehtësisë së aksesit të çdo individi dhe përdorimit të portaleve *online* nga një numër i pakufizuar personash.

Së dyti, përpos faktit se ofruesit e shërbimeve të publikimeve *online* nuk ofrojnë akses për paraqitjen e ankesave të mundshme, në legjislacionin aktualisht në fuqi nuk parashikohen qartësisht sanksione ligjore, lidhur me mosrespektimin e detyrimeve përkatëse për sa u përket kufizimeve të publikimit të përmbajtjeve të paligjshme apo të dëmshme.

Së treti, për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë së informacionit, gjatë viteve të fundit është vënë re një tendencë në rritje për sa i përket publikimit të materialeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme *online*.

Në nevojën për të rregulluar këtë fushë, e cila deri më sot është plotësisht e parregulluar, ka lindur roli dhe ndikimi që ka media elektronike në një shoqëri demokratike. Siç ju jeni në dijeni, fushat keqinformuese ose *fake news* kanë ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimet politike të një vendi, veçanërisht gjatë referendumeve apo zgjedhjeve. Sipas *Freedom House* manipulimi *online* dhe taktikat e keqinformimit kanë luajtur një rol në të paktën 10 vende të ndryshme. Nga ana tjetër, lajmi i rremë është shndërruar jo vetëm për Shqipërinë si një instrument ndërmjet të cilit gjenerohen të ardhura. Kjo edhe arsyeja pse në planin e veprimit të Komisionit European për keqinformim të datës 5 dhjetor 2018, keqinformimi është përkufizuar si shpërndarje e informacioneve të rreme dhe çorientuese për qëllime të fitimit ekonomik apo për të mashtruar qëllimisht publikun. Për më tepër, lajmi i rremë delegjitimon zërin e ekspertizës, cilësinë e gazetarisë të bazuar te faktet dhe të dhënat, si dhe prek aftësinë e publikut për t’u angazhuar në diskutuese të bazuara në fakte. Gjithashtu, vlen të theksohet se në ndryshimet e propozuara ky projektligj në një dispozitë të tij nuk cenon lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizuale dhe elektronike, por synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve jetike, në mënyrë që të

respektohet dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe diskursit publik.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera, si të Gjermanisë, Malit të Zi, Letonisë dhe Kroacisë dhe është konstatuar se rregullimi i përmbajtjes së publikimeve elektronike është normuar me ligj edhe në këto shtete. Gjatë përgatitjes dhe hartimit të dispozitave konkrete të këtij projektligji është mbajtur në konsideratë veçanërisht ligji kroat, i cili ka rregulluar në mënyrë të posaçme të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë dhe fizikë, të cilët ofrojnë shërbime medietike audio dhe audiovizuale dhe shërbimet e publikimeve elektronike nga rrjetet e komunikimit elektronik. Gjatë fazës së hartimit këto akte janë konsultuar gjerësisht me palët e interesuara, duke zhvilluar të paktën 4 tryeza konsultimi me palët e interesit. Gjithashtu, për hartimin e tyre është dhënë asistencë nga zyra e OSBE-së “Për lirinë e medias”, si dhe është punuar edhe me Komisionin e Ligjeve për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre drafteve. Pra, së fundi draftet kanë qenë në proces përmirësimi besoj se edhe nga Komisioni i Ligjeve duhet të jetë depozituar një draft i fundit i punuar.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Fillojmë me pyetjet drejtuar përfaqësuesve të ministrive dhe të institucioneve të AMA-s dhe AKEP-it.

Fjalën e ka zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, kryetar!

Zotëri i nderuar, ju thoni se ligji nuk censuron. Ju të Ministrisë së Drejtësisë e keni gati, doni një orar, doni edhe një program. Çfarë është kjo ? A nuk është censurë. Ju jeni djalë i ri dhe nuk e dini se çfarë është censura, ndaj pak më kujdes dhe duhet ta mendosh më mirë.

Aty ku fillon e drejta jote – sipas jush, si jurist - mbaron e drejta ime, apo e kundërta. Në këtë rast, a mund të ma tregosh se ku fillon e drejta e tyre? Ne kemi luftuar vite me radhë për të drejtën për të folur. Unë jam një nga njerëzit që jam përfolur edhe me ato që ju i quani “lajm të rreme”, ju e thatë në anglisht, por unë nuk jam anglishtfolës, ndaj po e them në shqip, dhe nuk kam bërë asnjë kallëzim. Në fakt, qeveria ka nisur kallëzimin penal për dy persona. Qeveria ka në pushtet 6 vjet e gjysmë dhe i ka mbetur edhe 1 vit e gjysmë dhe nuk ka shans ta kalojë këtë ligj, ndaj as ju mos e ndihmoni, i nderuar zoti Beja.

Faleminderit, zoti kryetar!

Edlira Hyseni – Unë kam një pyetje të thjeshtë. Pra, të dyja projektligjet që propozohen u referohen kësaj që është shumë e diskutuar, por më shumë e komentuar si “Paketa antishpifje”. Pyetja e parë që kam është: nëse sot ky komision po diskuton këto dy

projektligje kaq të rëndësishëm, që lidhen me mediet dhe të gjitha çështjet që i përkasin asaj, si ka mundësi prezenca pothuajse inegzistente e medias në këtë mbledhje, ndërkohë që në Komisionin e Ekonomisë nga unë vij e gjithë media ishte prezente, ndërkohë që këtu është vetëm një medie dhe unë nuk e di cila është? Unë mendoj se ky është një nga argumentet dhe një ndër debatet që duhet të ketë absolutisht një përhapje, në opinion të gjerë publik dhe shume komente, ndaj a është rastësore mungesa e medias në këtë mbledhje apo vërtet kërkohen të kalohen këto dy ligje, që mbase do të kërkojnë shumicë të thjeshtë dhe nuk do të duhet fare mendimi i opozitës? Meqenëse është një çështje shumë sensitive, mendoj se opinionin publik është shumë i ndjeshëm, pasi vijmë nga një sistem që, mbi të gjitha, kemi vuajtur mungesën e fjalës së lirë, mungesën e demokracisë apo të mendimit të lirë. Nëse sot diskutohet që kjo “Paketë antishpifje” do të cenojë mendimin e lirë, qoftë edhe nëpërmjet censurimit të medieve *online*, atëherë është mirë që të dëgjohet publiku, të dëgjohet qytetari, të dëgjohen të gjithë. Sot mediet nuk janë prezentë, ndaj ky debat këtu do të jetë shumë pak publik. A është kjo e qëllimshme apo rastësore, është pyetja e parë?

Së dyti, në dijeninë time për këtë paketë të famshme antishpifje ka një oponent edhe nga organizatat ndërkombëtare, ato që kujdesen për fjalën e lirë, mendimin e lirë e të tjera. A i keni marrë ju parasysh, a jeni në dijeni apo si do ta reflektoni oponentin e plotë që i është bërë kësaj “Pakete antishpifje” dhe nga partnerët apo organizatat e ndryshme ndërkombëtare?

Së treti, si do të realizohen konkretisht dhe cilat do të jenë ata që do të gjykojnë se cila do të jetë shpifje dhe cila jo? Kjo duket pak si subjektive dhe mund të jetë një argument që lë vend për interpretim, pra për subjektivitet. Pra, si do të arrini ta ndani objektivisht se çfarë do të kategorizohet si shpifje, joshpifje, këtë e bërë mirë apo këtë e ke bërë keq? Në fakt, preokupimi është i madh për një censurë të fjalës së lirë dhe unë shpresoj shumë që të mos të jetë ky qëllimi dhe objektiv, sepse, realisht, njerëzit kanë kaq shumë halle sa të paktën lërin fjalën e lirë, ju lutem.

Niko Peleshi – Dua të jap një përgjigje lidhur me mungesën e medias sot në komision, sepse kjo na takon ne si komision i organizmit. Në fakt, kjo mbledhje është lajmëruar që ditën e djeshme në faqen zyrtare të Kuvendit, por, duke qenë se zhvillohen disa komisione paralelisht mbase edhe mediet janë shpërndarë. Ne nuk jemi komisioni kryesor, jemi komision për dhënie mendimi dhe prekemi ose përfshihemi pak në këtë fushë vetëm për shkak të ligjit të komunikimeve elektronike. Pra, meqenëse këto dy ligje janë të lidhura, ky ligj ka ardhur edhe te ne, por mbase interesi është më i madh për Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin e Medies.

Po, fjalën e kanë zonja Gjermani, zoti Bitri dhe më pas zoti Gjuzi.

Eglantina Gjermani – Faleminderit për prezantimin!

Unë kam dy pyetje. E para, ky projektligj ka ngjallur shumë debat, prandaj dua të kem një përgjigje konkrete nëse ky projektligj i është nënshtruar diskutimit publik. A janë marrë mendimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit në konsideratë dhe të na thoni shkurtimisht se ku kanë konsistuar? A është përmirësuar projektligji që vjen në parlament?

E dyta, duke qenë se OSBE-ja ka qenë shumë aktive me reagimet e saj për projektligjin, unë e di që ata kanë kontribuar në përmirësimin e tij, pra a kemi një variant të përmirësuar dhe a është ky që kemi sot në tavolinë apo duhet të presim, meqenëse ne jemi komision për dhënie mendimi, të japim mendimet tona dhe më pas drafti final do të bëhet nga Komisioni i Ligjeve?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Në komentet që u bënë këtu theksohet që ka pasur kontestime. A mund të na thoni një apo dy elemente më kritike në procesin e komunikimit, pra të kontestimeve që janë bërë në ligj?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Nga ajo çfarë tha përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, OSBE-ja e ka parë dhe ka dhënë mendimin e saj për këtë, pra ose e ka miratuar ose nuk e ka miratuar. Pyetja është konkrete, a ka pasur vërejtje OSBE-ja për këtë gjë? Cilët janë dhe grupet e interesit, televizionet, portalet...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, publiku nuk është përfaqësues, përfaqësues janë njerëzit që përfaqësojnë publikun. Ne deputetët përfaqësojmë publikun, prandaj bëhen zgjedhje një herë në katër vjet, që publiku të përfaqësohet me ne dhe ne të marrim në konsideratë të gjitha gjërat e mira. Ky ligj është kontestuar, por liria nuk është pakufi. Të gjithë duhet të jemi të ndërgjegjshëm që, kur themi diçka, të mos prekim askënd, sepse çdo njeri ka individualitetin dhe personalitetin e tij. Liria e fjalës është që ti të tregosh fakte, nuk publikohet diçka pa pasur fakte. Pra duhet të vësh para përgjegjësisë, përpara faktit, sepse pjesa tjetër nuk i intereson as individit, as shoqërisë dhe as një njeriu. Ata që publikojnë një lajm të rremë duhet të mbajnë të gjitha përgjegjësitë sipas ligjit, sepse është një goditje shumë e madhe për çdo njeri që përfillet në mënyrë të papërgjegjshme.

Unë dua të di se cili është mendimi që kanë dhënë grupet e interesit?

Niko Peleshi - Fjalën e ka zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Zoti kryetar, faleminderit, por pyetjen ma dogji kolegu dhe nuk kam tjetër.

Niko Peleshi – Po, zoti Jakimi

Halil Jakimi – Duke e konsideruar si shumë të rëndësishme lirinë e fjalës dhe veprimtarinë e medieeve në Shqipëri, po përsëris disa organizata ndërkombëtare, të cilat janë shprehur kundër, siç është: Qendra Europiane për Lirinë e Medies dhe Shtypit, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Federata Europiane e Gazetarëve, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit, Reporterët pa Kufi, Këshilli i Europës, Komisioni Europian dhe OSBE-ja. Pyetja ime është: kur gjithë këto organizata janë shprehur kundër, përse AKEP-i po tenton të jetë fuqplotë në kontrollin e medieeve? Si u përgjigjeni zërave kundër?

E dyta, është shumë shqetësues fakti që ka pasur raste që medie dhe gazetarë janë intimiduar, janë përbuzur me emra të ndryshëm, si kazan, kosh e të tjera. Më duket e rëndë mënyra se si ju do të vlerësoni shpifjet, cila do të jetë prova? Çfarë jeni ju gjykatë, prokurori apo çfarë jeni? Si do të veprohet në këto raste? Unë mendoj se është shumë e vështirë të godasësh dikë dhe t'i thuash që kaq është gjoba, t'i mbyllësh medien ose të vendosësh një gjobë, e cila do të çonte në mbylljen e medies, pra të fjalës së lirë. Pra janë shumë të rëndësishme kriteret që do të zbatohen në klasifikimin e shpifjeve apo dixhiturave të tjera.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua ta nis me një vërejtje ndaj prezantimit, i cili bie ndesh me relacionin. Relacioni është shumë i qartë, dëgjova edhe komentet e relatorit, pra ne kemi nevojë ta dëshmojmë përmbajtjen e relacionit, sepse ka keqinterpretim të këtij ligji, që nga artikulli i titullit kur themi: “Ligji antishpifje”, sepse, në fakt, është një ligj për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Dinamika e zhvillimit të internetit dhe të mediave elektronike është aq e fuqishme, saqë ligjet që kemi miratuar para 5 vjetësh duken të vjetra dhe duhen ripunuar që t'i përgjigjen dinamikës së ndryshimit dhe efektit që kanë mendiet elektronike në glob dhe në realitetin shqiptar. Prandaj për publikun duhet të artikulojmë të vërtetën, pra që ky është një ligj që mbron lirinë e medies, lirinë e shprehjes dhe rregullon me një kornizë ligjore disinformimin dhe lajmet e rreme, si dhe jep impakt, aq sa mund të ndikojë, pa e prekur dhe pa cenuar lirinë e shprehjes, lirinë e medies dhe lirinë në përgjithësi, sepse liria është përgjegjësi dhe nuk është një e drejtë që duhet ta shpërdorosh.

Në këtë kuptim unë kam një pyetje, ku shikohet shkelja e asaj që quhet vija e kuqe, mes politikës dhe medias, sepse ka shumë zhurmë, shumë keqkuptime dhe keqinterpretim të çdo gjëje, që në fakt është e mbrojtur ligjërisht?

Së dyti, a kemi portale të paregjistruara sot, që i shmangen mbikëqyrjes që bëjnë organet kompetente në aspekt të disiplinimit, si nga rregullat e mbikëqyrjes, ashtu dhe nga detyrimet që i cakton ligji?

Së treti, Autoriteti i Medies a kontestohet si mbikëqyrës i medieve elektronike apo mirëpritet dhe është konsultuar nga grupet e interesit si institucioni që jep vlerësimin për të qenë korrekt në vërtetësinë apo dizinformimin e lajmit që japin mediet elektronike?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Vazhdojmë me përgjigjet nga përfaqësuesit e institucioneve.

Besmir Beja – Faleminderit për pyetjet!

Unë i kam kategorizuar pyetjet, megjithatë më korrigjoni nëse e kam kuptuar gabim. Pra pyetjet janë në lidhje me konsultimin e ligjit me publikun dhe organizatat ndërkombëtare, me mënyrën se si do të jenë mekanizmat e funksionimit të këtij instrumenti, pra me ndryshimet që ne propozojmë në raport me konsultimin.

Kjo paketë është konsultuar gjerësisht. Nisma për ndërmarrjen e këtyre ndryshimeve ka filluar përpara një viti dhe përpara se të vinte në Kuvend janë zhvilluar rreth 4 tryeza konsultimi nga grupi i punës dhe Këshilli i Ministrave që e kanë hartuar këtë projektligj. Gjatë këtyre tryezave janë ftuar media, portale e gazeta të ndryshme *online*, ekspertë të fushës edhe çdo palë tjetër që ka qenë e interesuar, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, mbi versionet fillestare. Në përputhje me kontributin e tyre janë bërë dhe ndryshimet e nevojshme të projektligjit. Pra mund të themi që ka një ndryshim të ndjeshëm në raport me propozimin fillestar që ka pasur kjo nismë dhe kemi marrë në konsideratë pjesën më të madhe të shqetësimeve që kanë pasur mediet dhe pjesa e publikut ose ndjeshmëria që krijon në publik kjo nismë.

Në raport me organizatat ndërkombëtare, mund t'ju them që kemi pasur asistencë nga zyra e OSBE-së, nga Këshilli i Europës, por edhe nga Komisioni i Bashkimit European. Me zyrën e OSBE-së kemi punuar veçanërisht për lirinë medias dhe lirinë e shprehjes, ata na kanë asistuar përgjatë gjithë kohës në hartimin e ndryshimeve ligjore. Pra edhe në nëntor të këtij vitit ne kemi punuar me ta me qëllim që drafti të ishte gjerësisht i pranuar dhe besoj se kemi arritur një rezultat të kënaqshëm. Në raportin e fundit, që është përcjellë nga eksperti i OSBE-së, përcaktohet qartësisht që ka përmirësime të ndjeshme nga draftet fillestare të depozituara.

Çështjet e fundit që kanë mbetur, në vlerësimin tim, janë çështje të natyrës teknike, të cilat mund të jenë të teknikës legislative ose, mbase, edhe nga përkthimi që i ka ardhur raportit. Pra janë çështje lehtësisht të zgjidhshme. Unë besoj se mund të kemi mbështetjen e plotë të ekspertit të OSBE-së në ndërmarrjen e kësaj nisme.

Në raport me mënyrën se si do të funksionojë mekanizmi ose se si bëhet ndarja mes shpifjes dhe joshpifjes, praktikisht ne nuk po propozojmë një instrument që të bëjë dallimin mes shpifjes dhe joshpifjes, por po krijojmë një instrument që do t'i garantojmë çdo qytetari, i cili ndjehet i prekur nga një publikim në mediet *onlien*, të ketë mundësi të adresohet fillimisht në medien *online*, më pas të bëjë ankimin në organet kompetente shtetërore, që në këtë rast do të jetë Këshilli i Ankesave dhe AMA, dhe më pas në gjykatë nëse mendon që informacioni është i pavërtetë ose ky informacion nuk përfaqëson siç duhet qasjen që ka pasur në dalje publike. Pra, është një instrument që garanton marrjen në konsideratë të shqetësimeve të individëve, por edhe qasjen e medias së caktuar që ka publikuar atë lajm, pra krijon hapat, shkallët dhe mekanizmat e duhur për të vlerësuar në çdo rast secilin prej qëndrimeve. Nëse qëndrimet që ka pasur qytetari apo individ i cenuar janë të bazuara, atëherë ose bëhet publikimi përgënjeshtres, ose mund të bëhet publikimi i njëkohshëm i lajmit, pra qëndrimi i individit në raport me lajmin e publikuar, ose në raste të tjera kur nuk zbatohen vendimet mund të merret një gjobë. Ky instrument është përzgjedhur një mjet efektiv që nga njëra anë të ruhet pluraliteti dhe liria e medias, por nga ana tjetër të mbrohen të drejtat dhe liritë e individit.

Në raport me kontestimet, pra cilat janë dy çështjet më të mëdha që janë kontestuar, besoj se kanë ardhur edhe nga moskuptimi i propozimit që ka ardhur, e cila lidhet me detyrimin ose jo për të regjistruar portalet. Pra nuk ekziston një detyrim për të regjistruar mediet elektronike, por është parashikuar si mundësi që portalet mund të regjistrohen në një regjistër të posaçëm që mbahet nga AMA. Ky regjistër është për të gjitha llojet e medieve, pra nuk është vetëm për portalet, i cili mund të sjellë lehtësira fiskale dhe lehtësira të tjera. Në rast të kundërt regjistrimi nuk është kusht për operimin si medie, veçanërisht për ato që nuk është i nevojshëm licencimi, pra në rastin e portaleve *online*. Kjo ka qenë një nga çështjet më të diskutuara dhe me zgjidhjen që i kemi dhënë aktualisht ky është një problem i tejkaluar, sepse nuk ka ndonjë detyrim për regjistrimin e portaleve në regjistrin e posaçëm të medias dhe mund të funksionojnë lirisht si medie në Shqipëri.

Për sa i përket pyetjes për përshtatshmërinë e AMA-s për të ushtruar këtë funksion, propozimi që kemi bërë vjen në këtë lloj qasje, pra parimi është: pavarësisht llojit të medias, qasja ligjore ndaj medias duhet të jetë neutrale, pra nuk ka përse një medie e caktuar të ketë

një rregullim ligjor ndryshe nga mediet e tjera. Në këtë kuptim për sa kohë që AMA është rregullatore e të gjitha medieve në Republikën e Shqipërisë dhe për sa kohë portalet *online* ushtrojnë funksionet e medieve, është çmuar që AMA është rregullatori më i përshtatshëm i të gjithë shërbimit të medieve në Shqipëri.

Nëse kam harruar ndonjë pyetje, jam në dispozicion.

Niko Peleshi – Po.

Dritan Bici – Duke parë letrat që kemi përpara, duket sikur diçka nuk shkon në këto ligje që do të shqyrtojmë sot, sepse në momentin e shqyrtimit të tyre kryetari i AMA-s ngrihet dhe ikën. Ai duhet të jetë prezent këtu.

Niko Peleshi – Ishte i ftuar në një komision tjetër.

Dritan Bici – Më vjen keq, sepse ne po merremi me këtë punë.

Së dyti, na vjen edhe dorëheqja e zotit Ilir Zela, i cili në një nga pikat e dorëheqjes ai thotë: "...pa lejuar në asnjë moment që interesat publike të nëpërkëmbën nga presioni i pandërprerë i interesave monopoliste..."

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkë janë, sepse në mbledhjen e dytë do të bëhet zëvendësimi i tij me atë që do të zgjidhet, por në thelb është i njëjti problem, sepse ai që ka dhënë dorëheqjen diçka ka pasur. Ai ka qenë drejtues i AKEPI-t, përse të mos e ftonim dhe ta dëgjonim edhe ne, nëse ai dëshiron, sepse, përderisa po merremi me këtë punë, ta dëgjonim edhe Ilir Zelën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam mendimin tim, Andrea.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq tani. Mendimi im personal është që ne nuk kemi vuajtur nga liria e shtypit, por nga e kundërta. Ne Jemi një shoqëri e brishtë që rrjedhim nga një mentalitet komunist që nuk na kanë lënë të flasim dhe jo më të kishim medie. Por unë nuk jam për amulli, pra nga mënyra se si veprohet në Shqipëri, ku një person hap 10 medie, jep një lajm te media e parë dhe me mediet e tjera ai e quan lajmin të mirëqenë duke bërë lajm të ditës. Unë them se duhet t'i shikojmë me kujdes këto gjëra dhe të mos nxitohemi, sepse sot jemi maxhorancë dhe duhet t'i bëjmë ligjet sikur jemi në opozitë që të mos na e vrasë "kurrizin".

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky projektligj vjen në momentin kur qeveria juaj i ka të gjitha pushtetet dhe nuk e kontrollon më askush, pra ka dhe të gjitha mediet. Këtë e shikojmë, sepse ne si kryetar partie,

kur bëjmë një aktivitet, duhet të fusim miq të marrim mediet. Pra edhe ato 3-4 portale që janë kundër qeverisë bllokohen, që do të thotë se nuk ka më asgjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, qeverinë nuk e ndalon më askush. Po i marr me radhë disa nga mediet që keni ju. Ju keni: ERTV-në, TVSH-në, Klanin, Top Channel-in dhe çdo media që është në këtë vend. Çfarë do të bëhet? Këto 4-5 portale që janë kundër, nuk kanë shumë ndikim publik, sepse ato që kanë ndikim i keni ju. Unë nuk jam dakord me këtë ligj dhe nuk do ta votoj asnjëherë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Që në vitet '91 kur ne filluam proceset demokratike dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike, Kuvendit të Shqipërisë i është dashur që të bëjë dhe të përmirësojë ligje në funksion të ndërtimit të kësaj shoqërie dhe të nevojave që i kanë lindur gjatë demokratizimit të jetës së vendit. Gjithmonë gjatë përgatitjes së projektligjeve dhe aprovimit të tyre në Kuvend ka pasur grupe interesi, që nuk kanë qenë dakord, ka pasur rritje të taksimeve dhe rritje të kontrollit, kuptohet kontrolli në raport me të punësuarit, në raport me detyrimet që duhet të ketë ndaj shtetit, në raport me deklarimin e pagave reale dhe në raport me të qenit i vëmendshëm ndaj punës që bën. Këtu nuk ka rëndësi nëse është medie apo një fabrikë mielli, por medie merr një rëndësi të më madhe, sepse është më e drejtpërdrejtë me publikun dhe zë një zë të më rëndësishëm, prandaj bëhet dhe një zhurmë e tillë. Por publiku është po njësoj i atakuar edhe kur ky është një produkt ushqimor, medietik apo një produkt tjetër.

Ne sot po diskutojmë për një projektligj, i cili tenton të rregullojë një fushë që është e parregulluar, siç është ajo e medieve elektronike. Ne kemi një kuadër ligjor për mediet audio e audiovizive dhe brenda këtij kuadri dëshirojmë të përfshijmë edhe mediet elektronike, të cilat nuk përfshihen sot në këtë projektligj. Unë nuk e kuptoj se përse mediet audio apo audiovizive duhet të jenë nën një kuadër të caktuar ligjor, kurse mediet elektronike, pra portalet, duhet të jenë jashtë këtij kuadri ligjor. Të dyja janë medie dhe të dyja transmetojnë informacione dhe mbijetojnë si rezultat i një aktiviteti ekonomik që kryejnë. Unë besoj se ky është edhe thelbi i këtij projektligji. Pra, duke qenë se ne nuk jemi komision përgjegjës dhe ndoshta nuk jemi specialistët më të mirë të kësaj fushe, unë besoj se duhet t'i qëndrojmë këtij parimi, pra parimit për të cilin vjen ky projektligj. Parimi është që të mund të krijojmë një kuadër ligjor edhe për mediet elektronike, të cilat në vitet e fundit kanë marrë një zhvillim të madh. Pastaj kur të futemi në shqyrtimin nën për nën nga kolegët mund të ketë kërkesa apo

ndërhyrje që mund ta përmirësojnë këtë ligj, por në parim nuk besoj se duhet të jemi kundër kësaj gjëje.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Për ta pasur pak më të qartë, në vijim edhe të pyetjes së zonjës Gjermani, në mos gaboj, veçanërisht OSBE-ja, por edhe organizata të tjera kanë shprehur shqetësime për këtë projektligj. Konkretisht, zoti Beja, cilat janë vërejtjet kryesore të OSBE-së dhe si janë pasqyruar ato në draftin e ri të ripunuar, siç thatë ju, nga grupi i punës, duke marrë në konsideratë edhe vërejtjet e OSBE-së ose të punuar së bashku, sepse kështu u paraqit? Të paktën kështu ka ardhur me *e-mail* nga Komisioni i Medias. Duke e marrë zyrtar këtë *e-mail* ne po e konsiderojmë si draft. Do të doja të dija nga ju, praktikisht dhe teknikisht, cilat janë nenet e kontestuara dhe si janë përmirësuar ato?

Besmir Beja – Një nga çështjet që ka pasur diskutim lidhej me parashikimin e të drejtës së ankimit në gjykatë. Në vetvete ligji nuk parashikonte drejtpërdrejtë të drejtën e ankimit në gjykatë, edhe për shkakun e thjeshtë që legjislacioni aktual shqiptar në fuqi, veçanërisht ligji për Gjykatën Administrative dhe Kodi i Procedurës Administrative, në çdo lloj rasti të veprimit ose të mos veprimit të organeve të administratës publike, i garanton të drejtën çdo qytetari ose çdo pale të prekur të ankohet në gjykatë. Për këtë shkak shumë të thjeshtë ligji nuk e kishte të parashikuar. Megjithatë eksperti kishte mendimin që kjo lloj e drejte duhej parashikuar shprehimisht në këtë ligj. Kështu që kemi vendosur parashikim që si ndaj vendimit të Këshillit të Ankesave, si ndaj vendimit të bordit të AMA-s, mund të ankohet drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente.

Një çështje tjetër lidhej me qartësimin nëse regjistrimi ishte apo jo i detyrueshëm. Pra, OSBE-ja ka qenë gjithmonë kundër pasjes së një regjistrimi të detyrueshëm në regjistrin që mban AMA, në raport me detyrimin për të ofruar shërbimet mediatike, pra për të funksionuar si media. Në ndryshimet që kemi bërë është qartësuar, edhe nga gjuha teknike e përdorur, pra është vendosur fjala “mund”, që këta lloj operatorësh mund të regjistrohen në regjistrin që administrohet nga AMA.

Një çështje tjetër lidhej edhe me gjuhën e përgjithshme që përdorej në mbrojtje të nderit dhe dinjitetit të personit. Kjo është hequr fare si paragraf për shkak se në vlerësimin e tyre mendohej që ky lloj formulimi mund të ishte shumë i gjerë dhe mund të keqpërdorej në të ardhmen. Pra, në versionin që është depozituar së fundmi janë ruajtur ngushtësisht ato kompetenca, të cilat janë qartësisht të përcaktuara në ligj dhe në asnjë lloj rasti nuk lejojnë keqpërdorimin ose keqinterpretimin e tyre kundrejt cenimit të lirisë së mediave. Pra, është

zgjedhur balanca më e mirë e mundshme ndërmjet mbrojtjes së të drejtës së individit dhe njëkohësisht mbrojtjes së lirisë së medias ose lirisë së të shprehurit.

Niko Peleshi – Vazhdojmë me të njëjtën pjesë. Në qoftë se OSBE-ja kishte këto dy vërejtje dhe ju i morët parasysh, te grupet e interesit cilat ishin ankesat ose përmirësimi që ata donin të bënin dhe cilat janë këto grupe interesi?

Besmir Beja – Mund t’ju them që pas çdo konsultimi që është bërë (në total janë bërë 4 konsultime), janë mbajtur shënime dhe janë bërë në formë tabelore të gjitha komentet që ka pasur secila prej organizatave, qoftë me shkrim, qoftë në formë verbale gjatë procesit të konsultimit. Pra, për dijeninë tuaj, mund t’ju sjell një kopje të të gjitha procesverbaleve që kemi mbajtur dhe mënyrën si është reflektuar secili prej komenteve.

Qëndrimet kanë qenë të ndryshme; nga qëndrimet parimore, të cilat, pavarësisht mënyrës së rregullimit, nuk donin asnjë rregullim. Pra, ata çmonin që mediat *online* nuk duhen rregulluar dhe shteti nuk duhet të ketë asnjë lloj forme influence në rregullimin e mediave *online*. Në vlerësimin tonë kjo binte ndesh edhe me qasjen e neutralitetit të medias dhe rregullimeve ligjore përkundrejt formave të ndryshme të ofrimit të medias. Çështjet e tjera kanë qenë të natyrës teknike, që mund të vinin edhe nga moskuptimi apo keqkuptimi i dispozitave, si dhe mosnjohja në thelb të propozimeve të parashtruara. Sidoqoftë, nga një vit më parë deri më sot, drafti ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, kështu që besoj se edhe kundërshtarët më të fortë të kësaj pakete do të jenë mjaftueshëm komod për ta mbështetur atë.

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Në vazhdim të fjalës sime, që mbajta pak më parë, duke qenë koshientë që nuk jemi komision përgjegjës për këtë, por jemi komision përgjegjës për AKEP-in, dua të di nga ju çfarë ndryshimesh vijnë në këtë ligj në lidhje me AKEP-in? Pra, çfarë ndryshimesh i atribuohen AKEP-it në lidhje me këtë ligj? Që të jemi të qartë edhe ne si kolegë edhe për diskutimet e mëvonshme që do të kemi.

Enea Karakaci – Përsëritet të gjithëve!

Mund t’i përgjigjem shkurtimisht, sepse kjo pyetje lidhet me projektligjin e dytë, që besoj është këtu për shqyrtim, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Kompetencat e AKEP-it janë të përfshira në këtë projektligj.

Ky projektligj vjen si rrjedhojë e amendimeve të mundshme që do të miratohen nga Kuvendi për projektligjin që ju po diskutoni për median audiovizive dhe shtesat përkatëse për portalet dhe për komunikimet elektronike. Ajo çfarë ajo përmban është referimi në vetvete i

shtesës së përkufizimit të ofruesit të shërbimeve të publikimeve elektronike, i cili rregullohet më në detaje te ligji pararendës, si dhe marrëdhënia që krijohet ndërmjet AMA-s dhe AKEP-it për sa i përket vendimmarrjes së Këshillit të Ankesave të AMA-s. Pra, në vendimmarrjet përkatëse që mund të marrë Këshilli i Ankesave i AMA-s ekzekutuesi është AKEP-i. Në dijeninë time, kemi edhe përfaqësues të AKEP-it për mënyrën se si kjo mund të bëhet në praktikë, i gjithë thelbi është implementimi i vendimmarrjes së Këshillit të Ankesave të AMA-s që do të bëhet nga AKEP-i.

Niko Peleshi – Ka pyetje, diskutime apo komente të tjera?

Atëherë, propozoj që ta miratojmë në parim projektligjin, pa avancuar në diskutimin dhe miratimin nen për nen, për shkak se nuk është projektligj brenda fushës sonë. Për shkak se pritet me të pika e komunikimeve elektronike dhe institucioneve përkatëse, që është AKEP-i, ka ardhur për dhënie mendimi te ne.

Që t'i futemi shqyrtimit nen për nen besoj se nuk e kemi kapacitetin e nevojshëm, në kuptimin e misionit të këtij komisioni, për ta bërë para komisioneve të tjera. Kështu që, të informohemi me ecurinë e dëgjësive publike me grupet e interesit dhe pastaj, në një ditë tjetër, në fillim ose në fund të javës që vjen, të hënën maksimumi, vazhdojmë me diskutimin dhe miratimin nen për nen. Si mendoni?

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Dy vota kundër. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet. Besoj se është edhe kuorumi i nevojshëm.

Pasi të kemi marrë disa inpute nga ecuria e miratimit edhe në komisionet e tjera, por edhe nga dëgjesat e zhvilluara nga komisionet më relevante, do të vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Faleminderit për prezencën dhe pjesëmarrjen tuaj aktive!

Për 5 minuta do të kalojmë në shqyrtimin e projektligjit tjetër.